



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Programi:

# “Përmirësimi i Aftësive Financiare dhe të Kontabilitetit për Gjyqtarët dhe Prokurorët”

## Moduli 4: Transaksione dhe Industri të Veçanta

**CFRR** >>>

Centre for Financial  
Reporting Reform



WORLD BANK GROUP

Funded by:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

**CIPFA** | **UHY** Elite  
Auditing, Tax & Consulting



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Ky program trajnimi është zhvilluar në kuadër të projektit SQARP i cili është i financuar nga SECO dhe zbatohet nga Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar (CFRR) e World Bank Group.



Centre for Financial  
Reporting Reform



SQARP is funded by:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**

Trajnimi është zhvilluar në partneritet me “The Chartered Institute of Public Finance and Accountancy” (CIPFA) dhe UHY Elite sh.p.k.

Për më tepër detaje ju lutem na shkruani në adresën: [sqarp\\_albania@uhy-elite.com](mailto:sqarp_albania@uhy-elite.com)

Ky module do te fokusohet ne kuptimin e funksionimit dhe ndikimit te bankave ne aspekt te kontabilitetit, raportimit financiar si dhe trajtimin e tyre ne rastet gjyqësore. Gjithashtu do te fokusohemi ne trajtimi e transaksioneve te veçanta siç janë ato me kapitalin dhe pronën. Ndërkohe fokus do ti jepet rolit te ekspertit dhe çështjeve te etikes profesionale.

## Objektivi

- ✓ Nëpërmjet këtij trajnimi gjykatësit dhe prokurorët do të kenë fituar një kuptim të qartë të kontabilitetit dhe raportimit financiar lidhur me transaksionet specifike.
- ✓ Ata do të jenë më të aftësuar për të trajtuar aspektet financiare të rasteve gjyqësore te lidhura me banket si pale ne gjykim apo dhe si burim informacioni ne një çështje gjyqësore.
- ✓ Familjarizimi i pjesëmarrësve me terminologjinë dhe zhargonin tipik te elementeve te transaksioneve me bankat, pronat apo kapitalin qe gjenden ne dosjet gjyqësore.
- ✓ Njohja e pjesëmarrësve me aspektet etike te lidhura me trajtimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar nga këndvështrimi I ekspertit.




- Transaksionet e Veçanta
  - Bankat
  - Kapitali
  - Pronat
- Etika profesionale, profesioni i auditit

**CFRR** >>>

Centre for Financial  
Reporting Reform



Funded by:

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO




- Transaksionet e Veçanta
  - Bankat
  - Kapitali
  - Pronat
- Etika profesionale, profesioni i auditit

**CFRR** >>>

Centre for Financial  
Reporting Reform



Funded by:

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Sektori bankar përfshin institucionet që ofrojnë një gamë të gjerë të shërbimeve, duke përfshirë marrjen e depozitave, dhënien e kredive, apo ofrimin e produkteve financiare të ndryshme për individë, biznese dhe qeveritë.

## Transaksionet e Veçanta-Roli i Bankave

Autoriteti Qendror



- Detyra kryesore e bankës qendrore është menaxhimi i politikave monetare për të kontrolluar inflacionin, rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar.
- Përveç kësaj, banka qendrore monitoron dhe rregullon aktivitetin bankar, duke siguruar që institucionet financiare të respektojnë ligjet dhe standardet e vendit në veprimtarinë e tyre.
- Në aspekt të raportimit financiar BSH ka ngritur dhe menaxhon Sistemin Raportues Statistikor që përbën tërësinë e formularëve ku raportohen të dhëna nga subjektet raportuese-Sistemit Raportues i Unifikuar” (SRU).

Bankat e Nivelit të dyte

Bankat Tregtare

- Entitete ligjore, tregtare ose degë të shoqërive të huaja, me qëllim fitimin, të cilat ushtrojnë aktivitet bankar (sipas licencimit përkatës).

Bankat e Investimeve

- Për shkak të rolit në ekonomi dhe informacionit që administrojnë, kanë rregullim të thelluar për sa i takon kontabilitetin dhe raportimit financiar. Këtu, përveç SRU, entitetet që ofrojnë shërbime jashtë gamës së licencimit bankar (p.sh. sigurime), raportojnë edhe sipas kërkesave përkatëse rregullatorë (p.sh. AMF).

Shoqëri Kursim-Krediti

- Sipas natyrës së shërbimeve dhe informacionit që duhet të administroj në ofrimin e tyre, ngarkohen edhe me detyra të monitorimit dhe raportimit të aktiviteteve të dyshimta por edhe të bllokimit të tyre në raste specifike.

Mikro-financa

Unione Financiar

- Kuadri raportues bazë është “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”

Institucionet e tjera (jo-banka)

Për shkak të rolit që merr sipas natyrës së shërbimeve që ofron dhe informacionit që duhet të administroj në levrimin e tyre, bankat ngarkohen edhe me detyra të monitorimit dhe raportimit të aktiviteteve të dyshimta por edhe të bllokimit të tyre në raste specifike.

## Transaksionet e Veçanta- Roli i Bankave ne lidhje me entitetet/individë

<i>Roli i Bankës</i>	<i>Përshkrim i shkurtuar</i>	<i>Çështje në fokus</i>
Ruajtës i vlerave monetare	Bankat mbajnë vlerat monetare për klientët e tyre, duke siguruar që të jenë të sigurta dhe në dispozicion sipas nevojës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacioni mbi balancat e llogarive dhe shpërndarja e tij.</li> </ul>
Procesues i Transaksioneve (arkëtime/pagesa)	Bankat sigurojnë transferimet e fondeve me saktësi dhe në kohë sipas kërkesës së klientit <u>por edhe në rast të kërkesave për ekzekutim nga entet që e kanë këtë pushtet</u> ( p.sh., vendim gjykatë, autoritet fiskale, etj.).	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raportimi në palë të treta (përfshi entet shtetërorë)</li> <li>• Bllokimi i transaksioneve.</li> <li>• Raportimi i aktivitete te dyshimta (RAD)</li> </ul>
Garantues/ Përfaqësues	Bankave siguron besueshmërinë e një transaksioni mes palëve përmes produkteve si “Llogarite e Bllokimit”, “Letër-Garanci” apo “Letër-Kredi”.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzekutimi i garancive.</li> <li>• Raportimi në palë të treta.</li> <li>• Raportimi i aktivitete të dyshimta</li> </ul>
Shërbimet e thesarit dhe investimeve	Bankat vepron si “palë ndërmjetëse” por edhe si “këshillues” në tregtimin e letrave me vlere (përfshi bonot e thesarit apo ato ndërkombëtare).	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raportimi në palë të treta.</li> <li>• Raportimi i aktivitete të dyshimta</li> </ul>
Huamarrës (depozitat me afat)	Bankave mbledh fonde monetare nga publiku (entitetet/ individë) për ti përdorur ne aktivitetin e saj duke paguar interesa.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacioni mbi balancat.</li> <li>• Raportimi i Aktivitete te Dyshimta.</li> </ul>
Huadhënës (Kreditimi)	Bankave i jep hua klientëve për t’i përdorur ne aktivitetin e tyre ne këmbim të interesave dhe komisioneve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Financimi dhe analiza e rrezikut.</li> <li>• Raportimi në palë të treta.</li> <li>• Raportimi i aktivitete të dyshimta</li> </ul>

Ky seksion synon të veçojë rolin e Bankave si “palë ndërmjetëse”, se si operacionet dhe vendimet e tyre ndikojnë në situatat ligjore, duke sjellë përpara gjykatësit dhe prokurorët një kontekst më të plotë të transaksioneve bankare në rastet ligjore.

### Transaksionet e Veçanta-Banka-Operacionet standarde

Kategoria	Transaksionet/Dokumentet	Aspektet kryesore të rëndësishme për Gjyqtarët dhe Prokurorët:
Operacionet Ditore	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Depozitimet/Tërheqjet e parave Cash</li> <li>✓ Urdhër-Xhirimet mes llogarive të veta/Këmbimet valutore</li> <li>✓ Transfertat</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Lëvizje nga dhe drejt palëve të treta që nuk lidhen me aktivitetin.</li> <li>✓ Cilat janë dokumentet dhe si mund të verifikohen transaksionet.</li> <li>✓ Si funksionojnë transfertat mes palëve në banka të ndryshme (Sistemi i pagesave dhe bankat korrespondente).</li> </ul>
Operacionet elektronike	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ E-banking</li> <li>✓ Bankomatet (ATM)</li> <li>✓ Karta/debiti krediti (të pranueshme vetëm nga banka emetuese)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Perse ka një kontratë për këto shërbime cilat janë përgjegjësitë që transferohen dhe roli i bankës.</li> <li>✓ Rreziku i identifikimit/autentifikimit të autorizimit të veprimeve</li> </ul>
Operacionet me kontratë	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Karta/debiti krediti me palët të treta (VISA, MASTERCARD, Diners...)</li> <li>✓ Pajisjet POS</li> <li>✓ POS-ET virtuale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Cili është roli i bankës në këto transaksione. Ku mund të gjendet informacioni në lidhje me to. Pse detajet e veprimeve me kartat e kreditit nuk gjenden në ekstraktin e llogarisë.</li> <li>✓ Karta e biznesit e përdorur për qëllime personale.</li> <li>✓ Pasojat për kartë-mbajtësin nëse karta e debitit/kreditit e vjedhur shfrytëzohet për transaksione. Po për zotëruesin e POS?</li> </ul>



Kontabilizimi i veprimeve për transaksionet standard bankare, lidhet kryesisht me menaxhimin e mjeteve monetare dhe sipas natyrës së shërbimit gjejmë gjurmë në disa preje pasqyrave financiare.

### Transaksionet e Veçanta-Banka-Operacionet standarde

Aktiviteti Bankar	Ndikimi ne pasqyrat financiare te entitetit (klientit)				Shënime Shpjeg.
	Pozic. Financiar (Balanci)	Performancës (PASH)	F. Monetar (Cash Flow)	Ndrysh. Kapital	
Ruajtje e vlerave monetare (Llogarite rrjedhëse)	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione Të ardh. nga interesat	Mjete Monetare	-	Detajim
Depozitimet/Tërheqjet e parave	<b>Aktive:</b> Llog. Arkës Llog. Bankës <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Mjete Monetare	Pagesa kapitali	-
Urdhër-Xhirimet mes llogarive të veta	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Mjete Monetare	-	-
Transferrat në llogarit të treta (brenda bankës, kombëtare apo ndërkombëtare)	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës, Llog. Klient <b>Detyrime:</b> Llog.Furnitorë <b>Kapital:</b> Kapitali, Dividinet	Shp. për komisione	Arkëtimet Pagesat	Pagesa kapitali Pagesa dividendi	-
Këmbimet valutore	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Mjete Monetare	-	-

Për ekzekutimin e pagesave apo arkëtimeve, në sistemin bankar përdoren dhe mjete të tjera elektronike si karta e debitit apo dhe dokumente fizik si ceku bankar.

### Transaksionet e Veçanta-Banka-Operacionet standard: Mjete specifike

Aktiviteti Bankar	Ndikimi ne pasqyrat financiare te entitetit (klientit)				
	Pozic. Financiar (Balanci)	Performancës (PASH)	F. Monetar (Cash Flow)	Ndrysh. Kapital	Shënime Shpjeg.
Tërheqje/Derdhje ne ATM përmes kartës se Debitit	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Arkëtimet, Pagesat	-	-
Pranimi i Pagesa me POS apo POS virtual	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Arkëtimet	-	-
Pranimi i “Cek Bankar”	<b>Aktive:</b> Llog. MM te tjera; Klient <b>Detyrime:</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Arkëtimet	-	-
Arkëtimi i “Cek Bankar” (te pranuar me pare)	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës, <b>Detyrime:</b> - <b>Kapital:</b> -	Shp. për komisione	Arkëtimet	-	-
Lëshimi i pagesës me “Cek Bankar”	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës, <b>Detyrime:</b> Furnitorët <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Pagesat	-	-
Furnitori “thyen” cekun bankar te lëshuar me pare	<b>Aktive:</b> - <b>Detyrime:</b> - <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Pagesat	-	-

Sipas kërkesës së klientit, bankat lëshojnë dokumente që vërtetojnë garantimin e transaksionit me kushte specifike ligjore duke luajtur rolin e garantuesit të zbatimit të kushteve të deklaruara.

### Transaksionet e Veçanta-Banka-Operacionet e grantimit apo përfaqësimit

Kategoria	Transaksionet/Dokumentet	Aspektet kryesore të rëndësishme për Gjyqtarët dhe Prokurorët:
Llogarite e Bllokimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Banka siguron se një personi/entiteti në një marrëveshje ka ngurtësuar një shume monetare dhe se kjo shume mund të lëvrohet të një nga palët sipas plotësimit/plotësimit të kushteve të përcaktuara në bllokim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Arsyet dhe modeli se si çelen këto llogari. Çfarë verifikon dhe garanton banka?</li> <li>✓ Ku pasqyrohen këto para në dokumentet/kontabilitetin e entitetit?</li> <li>✓ Falsifikimet/ Mashtrimet.</li> </ul>
Letër Garancitë	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Banka siguron besueshmërinë e një personi/entiteti në një marrëveshje tregtare, duke siguruar që detyrimet e tyre do të përmbushen.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Çfarë verifikon dhe garanton banka?</li> <li>✓ A pasqyrohen këto vlera në dokumentet/pasqyrat e entitetit?</li> <li>✓ Falsifikimet/ Mashtrimet.</li> </ul>
Letër Krediti	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Banka ofron siguri për të shitësin në një transaksion, duke garantuar që pagesat do të bëhen, por do të bëhen vetëm nëse janë përmbushur kushtet dhe kërkesat e specifikuar në letër.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Çfarë verifikon dhe garanton banka?</li> <li>✓ A pasqyrohen këto vlera në dokumentet kontabël/pasqyrat e entitetit?</li> <li>✓ A janë ato një kredi dhe a raportohen si të tilla?</li> <li>✓ Falsifikimet/ Mashtrimet.</li> </ul>

Operacionet e garantimit apo përfaqësimit në vetvete nuk sjellin regjistrim të transaksionit specifik (përveç komisioneve). Ndërkohë në momentin që ekzekutohen si garanci, regjistrohen si pagesa përkatëse të transaksionit bazë në fjalë.

### Transaksionet e Veçanta-Banka- Operacionet e garantimit apo përfaqësimit

Aktiviteti Bankar	Ndikimi ne pasqyrat financiare te entitetit (klientit)				
	Pozic. Financiar (Balanci)	Performancës (PASH)	F. Monetar (Cash Flow)	Ndrysh. Kapital	Shënime Shpjeg.
Llogari Bllokimi	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione Te ardh. nga interesat	Mjete Monetare -		Detajim
Letër Garancitë	<b>Aktive: -</b> <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Mjete Monetare -		Detajim
Letër Krediti	<b>Aktive: -</b> <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Mjete Monetare -		Detajim

Ky seksion synon te veçojë rolin e Bankave si “palë ndërmjetëse”, se si operacionet dhe vendimet e tyre ndikojnë në situatat ligjore, duke sjellë përpara gjykatësit dhe prokurorët një kontekst të plotë të transaksioneve bankare në rastet ligjore.

## Transaksionet e Veçanta-Banka-Operacionet e Thesarit/Investimet

<i>Kategoria</i>	<i>Transaksionet/Dokumentet</i>	<i>Aspektet kryesore të rëndësishme për Gjyqtarët dhe Prokurorët:</i>
<p>Bonot e Thesarit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Pjesëmarrja në ankandet e bonove te thesarit</li> <li>✓ Funksion ne tregtimin e bonovo ndaj publikut</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Çfarë verifikon dhe garanton banka?</li> <li>✓ Ku pasqyrohen këto para ne dokumentet e entitetit?</li> </ul>
<p>Letrat me Vlere ndërkombëtare</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Blerja e letrave me vlere.</li> <li>✓ Shitja e letrave me vlere ne ose para maturimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Rregullimi për ekspozimin ndaj kapitalit. Çfarë verifikon dhe garanton banka?</li> <li>✓ Ku pasqyrohen këto para ne dokumentet e bankës?</li> </ul>

Operacionet e garantimit apo përfaqësimit në vetvete nuk sjellin regjistrim të transaksionit specifik (përveç komisioneve). Ndërkohë në momentin që ekzekutohen si garanci, regjistrohen si pagesa përkatëse të transaksionit bazë në fjalë.

### Transaksionet e Veçanta-Banka-Operacionet e Thesarit/Investimet

Aktiviteti	Ndikimi ne pasqyrat financiare te entitetit (klientit)				Shënime Shpjeg.
	Pozic. Financiar (Balanci)	Performancës (PASH)	F. Monetar (Cash Flow)	Ndrysh. Kapital	
Blerja e letrave me vlere	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës Llog. e Aktiveve Financiare <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Pagesat	-	Detajim
Shitja e letrave me vlere	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës Llog. e Aktiveve Financiare <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Te ardhurat nga interesat	Arkëtimet		Detajim (i te ardhurave nga interesi)

Operacionet e garantimit apo përfaqësimit në vetvete nuk sjellin regjistrim të transaksionit specifik (përveç komisioneve). Ndërkohë në momentin që ekzekutohen si garanci, regjistrohen si pagesa përkatëse të transaksionit bazë në fjalë.

## Transaksionet e Veçanta-Banka-Operacionet e Borxhit

Kategoria	Transaksionet/Dokumentet	Aspektet kryesore të rëndësishme për Gjyqtarët dhe Prokurorët:
<p>Huamarrjet (Depozitat...)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Depozitat e përbashkëta vlera e “dhe”/”ose”</li> <li>✓ Depozitat me afat</li> <li>✓ Depozitat pa afat</li> <li>✓ ....</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Çfarë verifikon banka?</li> <li>✓ Falsifikimet/ Mashtrimet.</li> </ul>
<p>Huadhëniet (kreditë...)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Kreditë e kolateralizuara.</li> <li>✓ Kreditë e garantuara vetëm me dorëzani</li> <li>✓ Overdraftet (kreditë qarkulluese)</li> <li>✓ ....</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Çfarë roli luan banka ne lidhje me ekspozimin total te kredisë ndaj aftësive pagese te shoqërisë?</li> <li>✓ Për kreditë ne ekzekutim, kur përfundon llogaritja e interesave apo penaliteteve?</li> <li>✓ Ku mbahen përlllogaritjet dhe kur pasqyrohen ato ne llogarinë e klientit?</li> <li>✓ Kontratat e cedimit dhe sidomos ato me vlere materialisht me te vogël se detyrimi kredi-marrësit.</li> </ul>

Operacionet e garantimit apo përfaqësimit ne vetvete nuk sjellin regjistrim te transaksionit specifik (përveç komisioneve). Ndërkohë ne momentin qe ekzekutohen si garanci, regjistrohen si pagesa përkatëse te transaksionit baze ne fjale.

### Transaksionet e Veçanta-Banka-Operacionet e Borxhit

Aktiviteti	Ndikimi ne pasqyrat financiare te entitetit (klientit)				
	Pozic. Financiar (Balanci)	Performancës (PASH)	F. Monetar (Cash Flow)	Ndrysh. Kapital	Shënime Shpjeg.
Çelja e depozitës me afat	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës Llog. e Aktiveve Financiare <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione	Pagesat	-	Detajim
Marrja e interesave Mbyllje e depozitës me afat	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës Llog. e Aktiveve Financiare <b>Detyrime:-</b> <b>Kapital:-</b>	Te ardhurat nga interesat Shp. për komisione	Arkëtimet	-	Detajim (i te ardhurave nga interesi)
Marrja e kredive/disbursimi	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës <b>Detyrime:</b> Hua ash; Hua agj. <b>Kapital:-</b>	Shp. për komisione Shp. Admin (noter, bllokim hipotek. Etj.)	Arkëtimet	-	Detajim
Pagesa e kësteve te kredisë	<b>Aktive:</b> Llog. Bankës <b>Detyrime:</b> Hua (ash); <b>Kapital:-</b>	Shp. për interesa Shp. për penalitete	Pagesat	-	Detajim
Regjistrimi i plan- pagesës vjetore *)	<b>Aktive:</b> - <b>Detyrime:</b> Hua ash; Hua agj. <b>Kapital:-</b>	-	-	-	Detajim



Janë disa konceptet financiare të cilat pasqyrohen në rastet gjyqësore dhe shpesh gjenden të formuluar në zhargonin bankar e në trajta të komplikuar, por që kanë impakt në kuptimin e drejtë të çështjes.

## Transaksionet e Veçanta-Banka-Terminologji dhe koncepte të rëndësishme për gjyqtarët dhe prokuroret

### SWIFT IBAN

- **SWIFT** (*Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication*) Shoqata për Telekomunikimin Financiar Ndërkombëtar është një rrjet global i dërgesave.
- **Kodi SWIFT** ose Kodi Identifikues Bankar (BIC), është një kod identifikimi unik për një bankë të caktuar.
- **IBAN** (Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare) një format ndërkombëtar për identifikimin e llogarive. Zakonisht përbëhet nga 34 karaktere dhe përfshin vendi, shifrat e kontrollit, dhe numrin e llogarisë bankare.
- Në zhargon përdoret shpesh “**Kopje e SWIFTI**” për të dëshmuar pagese, i referohet kopjes së printuar firmosur dhe vulosur nga banka të instruksioneve të mesazhit SWIFT të dërguar për një transferte specifike.

### Vlera në Kohë e Parasë

- Në esencë, koncepti thekson se një leke sot ka më shumë vlerë në të ardhmen, për shkak se mund të investohet dhe të përfitojë interesat.
- Është koncept themelor për të koncepte të tjera financiare si diskontimi dhe vlerësimi i investimeve.

### Normat: interesi TB/BTH Libor Euribor Tribor

- **Interesi:** Çmimi huas i shprehur si % e vlerës së detyrimit për një afat të caktuar. Shprehet gjithmonë në terma 1 vjeçar (12 muaj) përveç rasteve kur jepet specifike periudha përkatëse.
- **TB/BTH** (*Treasury Bills/ Bono Thesari*). Norma e interesit e titujve të borxhit qeveritar e cila përcaktohet në ankandet që zhvillon banka qendrore. Referohet shpesh si norma baze ose norma *risk-free* (pra për borxhet pa rrezik për kthim). (publikohen në faqen e Bankës së Shqipërisë).
- **LIBOR** (*London Interbank Offered Rate*), **EURIBOR** (*Euro Interbank Offered Rate*), dhe **TRIBOR** (*Tokyo Interbank Offered Rate*) janë të gjitha norma interesi që përdoren në tregjet ndërkombëtare.
- **Perse interes e kredive në leke shpesh shprehen me formulën  $BTH+x\%$ ?**

Origjina e termi "*offshore*" në kontekstin financiar daton nga mesi i shekullit të 20-të. Fillimisht, ai u referua aktiviteteve ose entiteteve të vendosura përtej ujërave territorial të një vendi.

## Transaksionet e Veçanta-Banka-Terminologji dhe koncepte të rëndësishme për gjyqtarët dhe prokuroret

### *Offshore*

"*Offshore*" i referohet aktiviteteve apo entiteteve që ndodhen ose janë të regjistruara jashtë juridiksionit ku personi ose entiteti operon ose banon kryesisht

### Offshore Financial Centers (OFCs)

**Qendrat Financiare *Offshore*:** Janë juridiksionet me rregullime financiare dhe tatimore të favorshme që tërheqin individët dhe bizneset jo-rezidente për të regjistruar ose operuar aktivitete financiare. OFC-të shpesh ofrojnë përfitime si përjashtimet tatimore, privatësia dhe kërkesat e reduktuara të rregullimit.

### Kompanitë *Offshore*

Një **kompani *offshore*** është një subjekt ligjor i regjistruar në një juridiksion tjetër përveç atij ku operimet e saj kryhen. Këto entitete shpesh përdoren për biznes ndërkombëtar, mbrojtjen e asetëve, planifikimin e taksave dhe qëllime të privatësisë.

### *Offshore Banking*

**Bankimi *offshore*** i referohet shërbimeve bankare të ofruara nga bankat që ndodhen në OFC-te. Këto banka ofrojnë shërbime për jorezidentë, duke përfshirë llogaritë e depozitave, menaxhimin e investimeve dhe menaxhimin e pasurisë, shpesh me avantazhe si privatësia dhe tatimi i ulët.

### Investimet *Offshore*

Këto janë investimet që ndodhen në juridiksione *offshore*. Investimet *offshore* mund të përfshijnë fonde të huaj, aksione, obligacione, ose instrumente financiare të tjera.

Përdoruesit e krypto-valutave mund të mbulojnë identitetin e tyre, por transaksionet e tyre janë transparente në *blockchain*. Njohuria për teknologjinë mund të ndihmojë në verifikimin e identitetit të palëve në një transaksion.

### *Blockchain* dhe Kripto-valutat: Një epokë e re që pritet të ketë impakt të madh edhe në drejtësi

#### *Block-Chain*

Autentifikim informacioni pa pasur nevojë për një autoritet qendror.

- Është një strukturë e të dhënave e cila ruan informacionin në blloqe të sigurtë me kriptografi ku secili bllok është lidhur me blloqet e tjerë, duke e bërë të vështirë ndryshimin e informacionit të ruajtur.
- Për shkak të kësaj natyre, informacioni në *blockchain* mund të autentifikohet pa nevojën e një autoriteti qendror për të konfirmuar vërtetësinë e tij.
- Në fakt, ky është një model që është përdorur më parë nga njerëzimi, përpara përdorimit të institucioneve qendrore (p.sh., Regj. Gjendjes Civile për identitetin, Regj. Tregtar për shoqëritë apo Banka e Shqipërisë për Lek-un, etj.)

#### *Kripto-Valutat (Psh Bitcoin)*

Valute ku autentifikohet mbajtësi dhe/ose vërtetësia e transaksionit përmes *blockchain*.

- Janë monedha dixhitale të shkëmbyeshme që përdoren si para për të bërë transaksione në internet.
- Pavarësisht se shumë vende (autoritet qendrore) hezitojnë në njohjen e tyre si mjet shkëmbimi, individë në mbare botën tashmë i kanë pranuar ato edhe për shkak të avantazheve të tilla si anonimiteti, siguria por edhe fitimi që mund të merret nga ndryshimi i kursit të këmbimit.
- Për shkak se si funksionon kjo teknologji, transaksionet nuk janë të lidhura me identitetin e individit, duke e bërë të vështirë gjurmimin e pronarit të një llogarie, gjë që ka bërë mjaft tërheqëse për botën e krimit.



## ■ Transaksionet e Veçanta

- Bankat
  - Kapitali
  - Pronat
- Etika profesionale, profesioni I auditit.


**CFRR** >>>

Centre for Financial  
Reporting Reform



WORLD BANK GROUP

Funded by:

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

“Kapitali si një element dhe mundësi fitimi”. Në këtë seksion, qëllimi është të japim kuptimin e transaksioneve të kapitalit pasi ato përfshijnë investime financiare që mund të ndikojnë në proceset ligjore, duke kërkuar kuptim për të vlerësuar me saktësi provat financiare.

### Transaksionet e Veçanta - Kapitali

Objektivi	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Cilat janë transaksionet me kapitalin</li><li>✓ Aspektet ligjore dhe fiskale</li></ul>
Akti i themelimit	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Burimi i të ardhurave,</li><li>✓ Format e kontributit</li></ul>
Transaksionet	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Shit-blerje, Këmbime, Dhurimi, Trashëgimi</li><li>✓ Transaksionet komplekse</li><li>✓ Transaksionet fiktive</li></ul>
Aspekti fiskal	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Si trajtohen fitimet dhe humbjet kapitale</li></ul>
Aspekti ligjor	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Mashtrime dhe pastrim parash</li><li>✓ Konflikte sociale</li><li>✓ Evazion fiskal</li></ul>



## ■ Transaksionet e Veçanta

- Bankat
  - Kapitali
  - Pronat
- Etika profesionale, profesioni I auditit.


**CFRR** >>>

Centre for Financial  
Reporting Reform



WORLD BANK GROUP

Funded by:

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Njohja e rregullave dhe e praktikave të mira për transaksionet e pronës ndihmon në parandalimin e keqpërdorimit ose mashtrimin me pronën në kontekstin ligjor.

## Transaksionet e Veçanta - Prona

Objektivi	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Cilat janë transaksionet me pronat e pa luajtshme</li><li>✓ Aspektet ligjore dhe fiskale</li></ul>
Historia e krijimit të pronës	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Krijimi, Privatizimi, Kthimi për ish-pronarët, Trashëgimia, Blerja, Dhurimi</li><li>✓ Vlerësimi me vlerën e drejtë</li></ul>
Transaksionet	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Shit-blerje, Këmbime, Dhurimi, Trashëgimi</li><li>✓ Transaksionet komplekse</li><li>✓ Transaksionet fiktive</li></ul>
Aspekti fiskal	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Si trajtohen fitimet dhe humbjet nga shit blerja e pronës</li></ul>
Aspekti ligjor	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ Mashtrime dhe vjedhje pronash</li><li>✓ Konflikte sociale</li><li>✓ Evazion fiskal</li></ul>



# Përmbajtje



- Transaksionet e Veçanta
  - Bankat
  - Kapitali
  - Pronat
- Etika profesionale, profesioni i auditit

**CFRR** >>

Centre for Financial  
Reporting Reform



WORLD BANK GROUP

Funded by:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO



Kontabilisti Investigativ është një profesion ende i pa rregulluar në Shqipëri. Megjithatë detyrat specifike të këtij pozicioni shpesh mbulohen nga ekspertet e atashuar pranë gjykatave apo ekspertët e thirru mbi çështje në trajtim.

## Mashtrimi dhe etika > Kontabiliteti Investigativ

### *Shpjegimi i shkurtuar i degës dhe profesionit*

- Degë e specializuar e kontabilitetit që aplikon teknikat e hetimit për të analizuar të dhënat financiare dhe për të zbuluar mashtrimet ose mospërputhjet.
- Profesion me natyrë gjurmuese, i cili kombinon ekspertizën financiare me aftësitë analitike dhe njohurive juridike për të zbuluar veprimtari mashtruese apo mospërputhje financiare.

### *Zbatimi*

- ✓ **Zbulimi i mashtrimeve**
- ✓ **Hetimi i mospërputhjeve financiare:** Gjurmojnë parregullsitë, të identifikojnë shkaqet rrënjësore dhe të japin njohuri për procedimet ligjore.
- ✓ **Dëshmia si ekspertë:** Dëshmia bazohet në një kuptim të plotë të kufizimeve financiare, duke i dhënë gjykatës njohuri vendimtare për vendim-marrjen e informuar.

### *Aspektet kryesore të rëndësishme për Gjyqtarët dhe Prokurorët:*

- **Hetimi:** Kryejnë hetime të thelluara në çështjet financiare, duke synuar të zbulojnë mospërputhje/mashtrime.
- **Mbledhja e provave:** Mbledhin, analizojnë dhe interpretojnë provat financiare që mund të paraqiten në gjykatë.
- **Analiza financiare:** Duke përdorur mjete analitike shqyrtojnë të dhënat për të identifikuar prirjet, anomalitë apo modelet që mund të tregojnë mashtrime apo keq-menaxhim financiar.
- **Dëshmitarë/ekspertë:** Shpesh shërbejnë si ekspertë, duke dhënë opinionet dhe analizat profesionale.
- **Mbështetja ligjore:** Punojnë ngushtë me profesionistë ligjorë, si avokatët dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, për të ofruar ekspertizë financiar.
- **Mbështetja në gjyq:** Përtej dëshmimeve, ofrojnë mbështetje gjithëpërfshirëse në gjyq. Ndihmojnë juristet në përgatitjen për aspektet financiare të një çështjeje, duke dhënë njohuri mbi fushat e mundshme të mosmarrëveshjes financiare dhe duke ndihmuar në zhvillimin e strategjive ligjore.

Kuptimi i këtyre teknikave u lejon gjyqtarëve dhe prokurorëve të vlerësojnë burimet dhe besueshmërinë e provave. Në këtë seksion, qëllimi është të tregojmë përdorimin në kontekstin ligjor.

## Mashtrimi dhe etika > Teknikat e zbulimit të mashtrimeve

Teknika	Vështirësitë në Zbatim	Elementet që cenojnë besueshmërinë
Analiza e të dhënave:	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sigurimi i interpretimit të saktë.</li> <li>▪ Të dhëna komplekse kërkojnë aftësi të avancuara.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Kampionimi - Mostrat e njëanshme të të dhënave.</li> <li>✓ Interpretimi për të konfirmuar paragjykime.</li> </ul>
Treguesit e sjelljes:	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallimi i variacioneve normale nga aktivitetet e dyshimta.</li> <li>▪ Njohja e mire e sjelljes së punonjësve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Stereotipizimi dhe etalonët e sjelljes në një organizatë.</li> <li>✓ Paragjykimi.</li> </ul>
Kontrollet e brendshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zbatimi i kontrolleve pa penguar efektshmërinë operacioneve.</li> <li>▪ Përshtatja e kontrolleve me zhvillimet në mashtrime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Kontrollat e brendshme mund të raportohen në mënyrë selektive, duke maskuar dobësitë dhe duke ndikuar në besueshmërinë e të dhënave.</li> </ul>
Politikat e denoncuesit <i>Whistleblower</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndërtimi/rritja e besimit për të inkurajuar raportimin.</li> <li>▪ Mbrojtja e denoncuesve nga hakmarrja.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Raportet e sinjalizuesit mund të paraqiten në mënyrë selektive, duke ndikuar në besueshmërinë e të dhënave të ofruara në gjykatë.</li> </ul>
Investigimi Digjital	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të ndjekësh ritmin e teknologjive digjitale në zhvillim.</li> <li>▪ Ruajtja e integritetit të provave digjitale .</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Paragjykimet e hetuesit mund të sjellin paragjykime të paqëllimshme në interpretimin e provave digjitale</li> </ul>
Teknologjia <i>Blockchain</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të kuptosh aspektet teknike të <i>blockchain</i>.</li> <li>▪ Integrimi i <i>blockchain</i> me sistemet financiare tradicionale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Paragjykimet kundër ose pro <i>blockchain</i> mund të ndikojnë në mënyrën se si besueshmëria e saj portretizohet në gjykatë, duke ndikuar në besueshmërinë e të dhënave.</li> </ul>

Përgjegjësitë etike për kontabilistët dhe juristet ndajnë disa parime të përbashkëta. Në këtë seksion, qëllimi është të tregojmë dallimet dhe dilemat etike.

## Mashtrimi dhe etika > Përgjegjësitë Etike të Kontabilistëve dhe Juristëve

	<i>Juristet</i>	<i>Kontabilistët/ Financieret</i>
Mbrojtja e Klientit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojnë të drejtat dhe interesat ligjore të klientëve, ndonjëherë me përfaqësim të zellshëm brenda kufijve të ligjit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shërbejnë interesat financiare të klientëve duke ofruar informacion të saktë dhe të paanshëm financiar.</li> </ul>
Pavarësia	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrojnë gjykim të pavarur profesional gjatë përfaqësimit të klientëve, duke shmangur konfliktet e interesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ruajnë pavarësinë dhe objektivitetin kur kryejnë auditime ose japin këshilla financiare.</li> </ul>
Privilegji ligjor	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përfitoni nga privilegji avokat-klient, duke mbrojtur komunikimet ndërmjet avokatëve dhe klientëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zakonisht, nuk e kanë konceptin e privilegjit ligjor, por kanë për detyrë të raportojnë parregullsitë financiare.</li> </ul>
Sistemi kundërshtar	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lundrojnë në një sistem ligjor kundërshtar, duke mbrojtur interesat e klientëve të tyre në gjykatë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në përgjithësi punojnë në bashkëpunim për të ofruar informacion financiar dhe jo brenda një sistemi kundërshtar.</li> </ul>
Besnikëria dhe Kujdestaria Detyra <i>fiduciare</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpesh kanë një detyrë <i>fiduciare</i> për të vepruar në interesin më të mirë të klientëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në mënyrë tipike, nuk kanë një detyrë <i>fiduciare</i> ndaj klientëve, por kanë një detyrë të kujdesit dhe kompetencës.</li> </ul>

Ne vijim seksioni mund te thellohet ne kuptimin e diferencave mbi dilemave etike dhe përmes këtyre diferencave te kuptohen shkaqet qe sjellin ne shpjegim/kuptim jo te drejte te rasteve

## Mashtrimi dhe etika > Dilemat Etike (Për Diskutim)

Juristët përballen me sfida etike të lidhura me përfaqësimin ligjor, konfidencialitetin apo balancimin e përfaqësimit zellshëm me sinqeritetin, ndërsa kontabilistët kryesisht përballen me dilema në lidhje me integritetin financiar, konfidencialitetin dhe respektimin e rregullave.

### *Juristet*

- ✓ Juristet janë të lidhur me rregulla të rrepta të konfidencialitetit.
- ✓ Dilemat etike mund të ndodhin kur juristët (avokatët) zbulojnë informacion që mund të parandalojë dëme apo veprime të paligjshme, por janë të kufizuar nga privilegji i avokatit-klient.

### *Kontabilistet/ Financieret*

- ✓ Kontabilistët shpesh merren me informacion financiar të ndjeshëm.
- ✓ Dilemat etike mund të lindin kur kontabilistët zbulojnë veprime të paligjshme, mes detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin apo detyrës për të raportuar sjellje të paligjshme apo etike.

Konfidencialiteti  
dhe Privilegji i  
Avokatit-Klient



This document has been prepared within the framework of the project “Strengthening Quality of Auditing and Reporting Project for Building Capacity of Judicial System in Financial Reporting” Ref. No: SQARP-AL-CQS-3.1 in the Republic of Albania. This document is prepared by or on behalf of the following entities. It contains confidential and privileged information intended solely for the addressee. In the event that you are not the addressee and have accessed this document in error, please do not read, or disseminate it.



77 Mansell Street, London E1 8AN  
+44 (0)20 7543 5600

[cipfa.org](http://cipfa.org)

The Chartered Institute of Public Finance and Accountancy.  
Registered with the Charity Commissioners of England and Wales No 231060.  
Registered with the Office of the Scottish Charity Regulator No SCO37963.



“UHY ELite sh.p.k (the “Firm”) is a member of Urbach Hacker Young International Limited, a UK company, and forms part of the international UHY network of legally independent accounting and consulting firms. UHY is the brand name for the UHY international network. The services described herein are provided by the Firm and not by UHY or any other member firm of UHY. Neither UHY nor any member of UHY has any liability for services provided by other members.”

Address: Str. "Ibrahim Rugova" Pallati 17, H3, Apt.12, Tirane, Albania  
Tel. +355 4 2237199; +355 4 4502116  
[www.uhy-elite.com](http://www.uhy-elite.com) , [info@uhy-elite.com](mailto:info@uhy-elite.com)